



Bashkimi për Ndryshim Anamorava

STATUTI I BASHKIMIT PËR NDRYSHIM – ANAMORAVA

**GJILAN,
SHKURT 2022**

PREAMBULA

Në mars të vitit 2022, si grup i profesionistëve me mendim të ri politikë, nuk dëshironim të qëndronim më indiferent ndaj ngjarjeve politike, por të organizohemi maksimalisht dhe drejtëpërsëdrejti në proceset politike kosovare.

Andaj, vendosum të unifikohe mi për një qëllim të përbashkët madhor: sjellja e një frymë të re liberale në sferën politike të shoqërisë kosovare. Pra Bashkimi për Ndryshim – Anamorava është ndërtuar mbi parimet fundamentale liberale të së qendrës si: liria, barazia, drejtësia dhe solidariteti.

Përmes përfshirjes në skenën politike kosovare, Bashkimi për Ndryshim – Anamorava synon të jap kontributin e saj në forcimin e demokracisë liberale, sundim të ligjit dhe zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Ne zotohemi se do të punojmë me të gjitha kapacitetet tona për mbrojtjen e sovranitetit të shtetit dhe përfaqësim dinjitoz të interesave qytetare – sot, nesër dhe përgjithnjë.

Neni 1 (Emri)

- 1) Partija mban emrin **Bashkimi për Ndryshim – Anamorava**. Shkurtesa zyrtare e emrit të partisë është “**BNA**”, e cila duhet të përdoret edhe në të gjitha seksionet, nëndegët dhe degët e partisë.

Neni 2 (Qëllimet dhe Vizioni Politik)

- 2.1 BNA është parti liberale e qendrës – pra, një tërësi e individëve të bashkuar mbi idetë dhe mendimet e përbashkëta, të paraqitura në statut dhe planprogramin e partisë.
- 2.2 BNA përmes pjesëmarrjes politike synon të kontribuojë në forcimin e demokracisë, ndërtimit të një shoqërie të hapur dhe përmirësimin e jetesës së qytetarëve të Republikës së Kosovës.
- 2.3 BNA operon në frymë me kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Prandaj BNA synon ta zhvilloj më tej Republikën e Kosovës si vend demokratik i bazuar në sundimin e ligjit dhe demokracisë kushtetuese dhe duke respektuar në tërësi parimin e ndarjes së pushteteve.
- 2.4 BNA synon të promovojë respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe komuniteteve jo-shumicë të garantuara me konventat dhe instrumentet ndërkombëtare. BNA është mbështetëse e lirisë individuale, pra mungesës së interferimit të shtetit në hapsirën private.
- 2.5 Lirinë e tregut dhe nxitjen e konkurrencës së barabartë, BNA e sheh si mjet për zhvillim dhe prosperitet. BNA, mbështet parimin e mosndërrhyrjes së shtetit në ekonomi, sepse tregjet vetërregullohen nga dora e fshehur e ekonomisë.
- 2.6 BNA përkrah idenë e një qeveri minimale, dhe kjo nënkupton që do të reduktoj shpenzimet publike qeveritare. BNA konsideron se 12 ministri janë të mjaftueshme për të qeverisur me shtetin.
- 2.7 BNA objektivat e saja, i konkretizon në përputhje të plotë me parimet dhe procedurat demokratike. Pjesëmarrja jonë politike realizohet vetëm me anë të instrumenteve demokratike, pra atë të votës së lirë të shtetasve të Republikës së Kosovës.
- 2.8 Të garantoj respektimin e të drejtave të gruas, përmes pjesëmarrjes së barabartë të grave në jetën politike dhe publike në Kosovë. Aty ku është e nevojshme do të përdoret edhe masa afirmative, si kuota gjinore në avancimin e interesave të gruas.
- 2.9 BNA synon të angazhohet fuqishëm që rinia e Kosovës të jetë pjesë aktive e vendim-marrjes. Për këtë arsye, BNA_ja do të jetë përkrahëse e madhe e pjesëmarrjes së të rinjëve në jetën shoqërore dhe politike.

- 2.10 Të angazhohet në integrimin e Republikës së Kosovës në mekanizmat rajonal dhe ndërkombëtar. BNA fuqishëm mbështet integrimin e Kosovës në Bashkimin Europian dhe Aleancën Veri-Atlantike, si dhe forcimin e partneritetit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Neni 3 (Selia)

- 3.1 Selia qendrore e BNA_së është në Gjilan.

Neni 4 (Vula dhe Logo)

- 4.1 BNA ka vulën, logon dhe flamurin e saj.
- 4.2 Përmbajtja e vulës në formë rrumbullake me shkronjën A në mes të saj dhe emrin e partisë rreth e rrotull vijave rrethore. Vula mund të jetë me ngjyrë të kaltërt apo të zezë.
- 4.3 Stema dhe flamuri

4.3.1 Stema dhe flamuri kanë sfond të bardhë; kanë shkronjën "A" me ngjyrë të kaltërt dhe ngjyrë ari tek e cila vija ndarëse e shkronjës "A" ka dy duar të lidhura dhe mbrenda ndarjes së saj ka të shkruar inicialet KMMG dhe keto inicialet KMMG nënkuptojnë Karadaku, Morava, Malësia dhe Gollaku. Në shkronjën "A" ka të shkruar emërtimin e partisë edhe atë si vijon: "Bashkimi për Ndryshim" dhe nën tekstin "Bashkimi për Ndryshim" ka të shkruar tekstin "Anamorava" dhe sejcila shkronjë e parë e emërtimit është me ngjyrë ari ndërsa pjesa tjetër e shkronjave ka ngjyrë të kaltërt.

Neni 5 (Dokumentet bazë)

Dokumentat bazë të BNA_së janë:

- (a) Programi dhe
- (b) Statuti i BNAsë.

Neni 6 (Anëtarësimi)

- 6.1 Anëtarë i partisë mund të jetë çdo qytetarë i Republikës së Kosovës që ka mbushur moshën 18 vjeçare dhe pajtohet me vizionin e partisë.
- 6.2 Anëtarët e BNA_së që jetojnë jashtë teritorit të Republikës së Kosovës gëzojnë të drejtën e organizimit të strukturave të BNA_së në shtetet ku jetojnë, përmes të cilave kanë të drejtat e pjesëmarrjes së barabart në Kuvendin Zgjedhor.
- 6.2 Nuk lejohet që anëtari i BNA_së, të jetë njëkohësisht i regjistruar edhe si anëtar i një subjekti tjetër partijak në Kosovë.
- 6.3 Anëtarësimi i antarëve bëhet në baza vullnetare në çdo seksion, nendegë, degë apo edhe në selinë qendrore.
- 6.4 Largimi i antarëve mund të bëhet në baza vullnetare me një njoftim paraprak me shkrim pran organeve përkatëse të BNA_së pa qenë i detyruar të japë shpjegime.

- 6.5 Largimi i anëtarëve mund të ndodh gjithashtu edhe në bazë të masave disiplinore eventuale në rast se anëtari vepron në kundërshtim me statutin, programin dhe vendimet e forumeve të BNA_së.

Neni 7 (Të drejtat e anëtarëve)

- 7.1 Çdo anëtar ka të drejtën e plotë të shprehjes së mendimit në mënyrë të lirë dhe të pavarur.
- 7.2 Të marrë pjesë në aktivitete dhe iniciativat e organizuara nga partia.
- 7.3 Secili anëtar ka të drejtë të marr pjesë apo te propozoj dhe të propozohet për gara të mbrendshme zgjedhore të partisë.

Neni 8 (Përgjegjesisit e anëtarëve)

- 8.1 Anëtari i partisë duhet të angazhohet që të shtyj përpara platformën politike të BNA_së.
- 8.2 Anëtari i partisë duhet të rrespektoj aktet politike të derivuara nga partija.
- 8.3 Nuk duhet të ndaj informacione apo dokumente të rëndësishme të partisë pa miratimin paraprak të kryetarit, nënkryetarit apo sekretarit organizativ të partisë.
- 8.4 Të pranoj vendimet e shumicës dhe të rrespektoj mendimin ndryshe.
- 8.5 Te mospërfshihet në veprimtari apo sjellje të cilat janë kompromentuese për etikën dhe moralin qytetar dhe cenimin e imazhit të BNA_së.

Neni 9 (Struktura organizative e partisë)

BNA përbëhet nga dy nivele:

- 9.1 Niveli Lokal dhe
- 9.2 Niveli Qëndror
- 9.1 Organet lokale janë:
- 9.1.1 Seksioni
- 9.1.2 Nëndega
- 9.1.3 Dega
- 9.2 Organet qendrore të BNA_së janë:
- 9.2.1 Kuvendi i BNA_së
- 9.2.2 Këshilli i Përgjithshëm
- 9.2.3 Kryetari
- 9.2.4 Kryesia
- 9.3 Në kuadër të organizimit të BNA_së funksionojnë edhe Forumi i Gruas dhe Forumi Rinor i BNA_së.

9.3.1 Kryetarja e forumit të gruas dhe atij rinor të BNA_së zgjidhen sipas rregullorës së mbrendshme të BNA_së.

Neni 10 (Organet lokale)

Janë njësi të organizimit dhe të veprimit territorial të BNA_së. Organet lokale janë:

- 10.1 Seksioni
- 10.2 Nëndega
- 10.3 Dega

Neni 11 (Seksioni)

- 11.1 Seksioni është njësia më e vogël e organizimit të BNA_së.
- 11.2 Organizimi i saj bëhet në baza lagjeje, vendvotime apo lokalitet të caktuara.
- 11.3 Seksionin e udhëheq koordinatori i seksionit i zgjedhur nga anëtarët e saj.
- 11.4 Përbërja e Seksionit ka së paku 5 anëtarë.
- 11.5 Për themelimin apo shuarjen e Seksioneve vendosë Kryesia e nëndegës.

Neni 12 (Nëndega)

- 12.1 Nëndega është njësi e mesme e organizimit politik të BNA_së.
- 12.2 Ajo përbën urën lidhëse mes Seksionit dhe Degës.
- 12.3 Nëndega përbëhet nga së paku dy seksione.
- 12.4 Organet e Nëndegës janë:
 - 12.4.1 Kuvendi i Nëndegës
 - 12.4.2 Kryesia e Nëndegës
 - 12.4.3 Kryetari i Nëndegës
 - 12.4.3.1 Kryetari i nëndegës organizon veprimtarinë e BNA_së në territorin administrativ të nëndegës.
 - 12.4.3.2 Thret dhe udhëheq mbledhjet e nëndegës.
 - 12.4.3.3 Njofton me shkrim dhe me goje kryetarin dhe kryesin e degës për çdo mbledhje apo aktivitet të nëndegës.
 - 12.4.3.4 Nënshkruan të gjitha vendimet e marra nga nëndega.
 - 12.4.3.5 Harton dhe administron listën e anëtarëve të BNA_së pran nëndegës.
- 12.5 Zgjedhë dhe delegon delegat për kuvendin e degë.

Neni 13 (Dega)

- 13.1 Dega është forma më e lartë e organizimit të nivelit lokal të BNA_së.
- 13.2 Degët janë njësi të organizimit në nivel komune, sipas ndarjes territoriale dhe administrative të Kosovës.
- 13.3 Organet e degës janë:
 - 13.3.1 Kuvendi i Degës
 - 13.3.2 Këshilli i Degës
 - 13.3.3 Kryesia e Degës
 - 13.3.4 Kryetari i Degës
- 13.4 Kuvendi Zgjedhor i Degës mbahet çdo 4 (katër) vjet dhe i paraprinë Kuvendit të BNA_së.
- 13.5 Dega mban kuvend pune së paku njëherë në 2 (dy) vite.

Neni 14 (Kuvendi i Degës)

- 14.1 Është organi më i lartë i BNA_së në nivel dege.
- 14.2 Zgjedh kryetarin e degës sipas procedurave të parapara nga statuti i BNA_së.
- 14.3 Zgjedh këshillin drejtues në pajtim me statutin e BNA_së.
- 14.4 Miraton Programin e Punës së Degës.
- 14.5 Mundë të thirret me vendim të këshillit të degës me kërkesen e 1|3 të anëtarëve të saj në degë apo me kërkesë të kryesisë qendrore të BNA_së.

Neni 15 (Kryetari i Degës)

- 15.1 Drejton veprimtarin e BNA_së në territorin e komunës përkatëse
- 15.2 Thëret dhe drejton mbledhjet e kryesisë së degës.
- 15.3 Nënshkruan të gjitha vendimet e marra nga kryesia e degës.
- 15.4 Drejton fushatat zgjedhore komunale dhe të përgjithshme në nivel dege.

Neni 16 (Këshilli i Degës)

- 16.1 Sipas kriterit të përfaqësimit anëtarë të këshillit të degës janë: të zgjedhurit e asamblesë komunale, kryetarët e nëndegëve, deputetët, të emëruarit-zgjedhurit për organe qeverisjes komunale, kryetarja e forumit të gruas dhe kryetari i forumit rinor.
- 16.2 Zgjedhë nënkryetarin, sekretarin dhe kryesin e degës me propozim të kryetarit të degës të BNA_së.
- 16.3 Miraton kandidatet e propozuar për Kuvende Komunal me propozim të Kryetarit dhe Kryesisë së degës.

Neni 17 (Kryesia e Degës)

- 17.1 Kryesia e degës është organ politiko-ekzekutiv i Kuvendit të Degës dhe i përgjigjet për realizimin e vendimeve të organeve më të larta të BNA_së.
- 17.2 Numri i anëtarëve të Kryesisë së Degës ka së paku 11 anëtarë (me mundësi zgjerimi sipas propozimit të Kryetarit të degës dhe aprovimin e Këshillit të Degës.
- 17.3 Kryesia e Degës ka Kryetarin, nënKryetarin dhe Sekretarin.
- 17.4 Në Kryesinë e Degës së BNA_së me të drejta të plota merr pjesë edhe Kryetarja e Forumit të Gruas dhe Kryetari i Forumit Rinor.
- 17.5 Propozon kandidatët për deputet, kryetar komune dhe kandidatët për Kuvend Komunal, në pajtim me Kryetarin e Degës

Neni 18 (Organet qendrore)

Organet qendrore të BNA_së janë:

- 18.1 Kuvendi i BNA_së
- 18.2 Këshilli i Përgjithshëm
- 18.3 Kryetari
- 18.4 Kryesia

Neni 19 (Kuvendi i BNA_së)

- 19.1 Kuvendi është organi më i lartë i BNA_së.
- 19.2 Kuvendi mund të jetë:
 - 19.2.1 Kuvend pune
 - 19.2.2 Kuvend i jashtëzakonshëm
 - 19.2.3 Kuvend zgjedhor
 - 19.2.1 Kuvendi i punës
 - 19.2.1.1 Kuvendi i BNA_së përbëhet nga delegatë të zgjedhur në kuvendet e degëve, anëtarët e kryesisë së vjetër të BNA_së, deputetet, zv. Ministrat, Ministrat dhe Kryetarja e Forumit të Gruas dhe atij Rinor.
 - 19.2.1.2 Për numrin e delegatëve vendos Këshilli i Përgjithshëm, respektivisht Kryesia e BNA_së.
 - 19.2.1.3 Punën e kuvendit të BNA_së e udhëheq Kryetari i BNA_së dhe kryesia e cila zgjedhet në Kuvend.

19.2.1.4 Vendimet e Kuvendit janë të plotëfuqishme në qoftë se në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve dhe nëse për të votojn shumica e pranishme.

19.2.1.5 Vendimet në Kuvend merren me votim të mbyllur ose të hapur.

19.2.1.6 Zgjedhja e organeve të BNA_së bëhet me votim të mbyllur ose të hapur.

19.2.2 Kuvendi i Jashtëzakonshëm

19.2.2.1 Kuvendi i jashtëzakonshëm, mundë të thirret sipas nevojës nga kryesia qendrore apo me kërkesën e 2/3 të anëtarëve të kuvendit

19.2.3 Kuvendi zgjedhorë

19.2.3.1 Kuvendi i rregullt zgjedhor i BNA_së do të mbahet një herë në 4 (katër) vite.

19.2.3.2 Kuvendi zgjedhor përveq Kryetarit zgjedhë Këshillin dhe zgjedhë Komisionet për mbarëvajtjen e zgjedhjeve.

19.3 Kohëzgjatja e mbajtjes së kuvendeve zgjat nga 8 deri në 48 orë pune duke zbatuar rregulloret e mbrendshme të punës, duke siguruar korumin e nevojshëm dhe rrespektuar rendin e ditës dhe të vendim marrjes.

Neni 20 (Kompetencat e Kuvendit)

Kuvendi i BNA_së ka këto kompetenca:

20.1 Zgjedhë Kryetarin e BNA_së.

20.2 Zgjedhë Këshillin e Përgjithshëm të BNA_së.

20.3 Vlerëson punën e organeve qendrore të BNA_së si dhe të organeve tjera.

20.4 Miraton statutin, programin dhe ndryshimet eventuale të tyre.

20.4 Nxjerrë deklarata, rezoluta dhe merr vendime gjat kuvendit të punës së rregullt

Neni 21 (Këshilli i Përgjithshëm)

21.1 Këshilli i Përgjithshëm përbëhet nga 31 anëtarë.

21.2 Anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm janë njëkohësisht edhe Kryetari, nënKryetarët dhe Sekretari i partisë.

21.3 Mandati i anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm është 4 (katër) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

21.4 Këshilli i Përgjithshëm merr vendimet me anë të procedurës së shumicës së thjeshtë (50% + 1).

Neni 22 (Kompetencat e Këshillit)

Këshilli i BNA_së ka këto kompetenca:

- 22.1 Propozon programin dhe statutin e BNA_së.
- 22.2 Inicon ndryshimin e statutit apo programit të partise politike në bazë të nevojave aktuale me shumice absolute.
- 22.3 Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e kryesisë, nënkryetarët dhe sekretarin e përgjithshëm të BNA_së në pajtueshmëri me Kryetarin e BNA_së.
- 22.4 Vëzhgon realizimin e vendimeve në Kuvendin e BNA_së.
- 22.4 Merr vendim për shpalljen e zgjedhjeve në BNA.
- 22.5 Harton Planin Financiar të BNA_së.

Neni 23 (Kryetari)

- 23.1 Kryetari është udhëheqësi i BNA_së dhe përfaqëson unitetin e të gjithë anëtarëve të BNA_se.
- 23.2 Kryetari zgjedhet nga Kuvendi i BNA_së në përputhje me Statutin.
- 23.3 Mandati i rregullt i Kryetarit zgjatë 4 vjet gjegjësisht deri në mbajtje e kuvendit të radhës.
- 23.4 Për punën e tij Kryetari i Përgjigjet Kuvendit të BNA_së.
- 23.5 Në mungesë të Kryetarit, detyrën e tij e ushtron njëri nga nënkryetarët.

Neni 24 (Kompetencat e Kryetarit)

Kryetari ka këto kompetenca:

- 24.1 Kryetari e përfaqëson BNA_në.
- 24.2 Udhëheqë punën e BNA_së dhe organeve të saja.
- 24.3 Propozon nënkryetarët, sekretarin e përgjithshëm të BNA_së.
- 24.4 Propozon përbërjen e delegacionit të BNA_së mbrenda dhe jashtë vendit.
- 24.5 Bashkarisht me Kryesinë jep propozimin përfundimtar për listën e kandidatëve të BNA_së per Parlamentin e Republikës së Kosovës.
- 24.6 Propozon anëtarët e Kryesisë.
- 24.7 Bashkarisht me Kryesinë propozon përjashtimin nga BNA_ja e gjithë atyre që veprojnë në kundërshtim me Politikat e BNA_së dhe nuk i përmbahen disiplinës partiake.
- 24.8 Në konsultim me Kryesinë dhe Këshillin e Përgjithshëm vendos të hyjë në koalicion para dhe pas zgjedhor.

24.9 Mbledhjet, takimet I thret Kryetari permes sekretarisë.

Neni 25 (Kryesia)

25.1 Kryesia është organ menaxhues dhe politiko-ekzekutuesi BNA_së.

25.2 Kryesia përbëhet së paku prej 15 anëtarëve (me mundësi zgjerimi).

25.3 Organizimi dhe funksionimi i kryesisë bëhet me rregullore të veçant.

25.4 Kryesia e partisë përbëhet nga Kryetari, Nenkryetarët, Sekretari i partisë dhe anëtarët e Kryesisë

Anëtarët tjerë të kryesis janë:

25.5 Kryetarja e forumit të gruas

25.6 Kryetari i forumit rinor

25.7 Kryetarët e degëve

25.8 Zgjerimi i anëtarëve tjerë të Kryesisë vendoset me propozim të Kryetarit të BNA_së dhe kryesisë.

25.9 Kryesia zgjedhet nga Këshilli i Përgjithshëm.

25.10 Në bazë të propozimit të Kryetarit të BNA_së Këshilli i Përgjithshëm zgjedh Nenkryetarët dhe Sekretarin e Përgjithshëm të BNA_së.

25.11 Zgjedh komisionin për mbikqyrje- kontrollin financiar.

Neni 26 (Kompetencat e Kryesisë)

26.1 Kryesia përfaqëson BNA_në.

26.2 Angazhohet që çdo kryesi e degëve dhe nëndegëve t'i përmbush detyrimet të përcaktuara me Statut.

26.3 Jep pëlqimin përfundimtar për listën e kandidatëve të BNA_së për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

26.4 Jep pëlqimin përfundimtar për listën e kandidatëve për ministra nga radhët e BNA_së.

26.5 Jep pëlqimin përfundimtar për kandidatët e BNA_së për Kryetar Komune dhe kandidatët për Kuvend Komunal.

26.6 Zgjedh shtabin zgjedhor.

26.7 Zgjedh një komision mbi kontestet mbrenda partisë lidhur me interpretimin e statutit.

26.8 Kryesia është përgjegjëse për zbatimin e programit dhe të statutit të saj

26.9 Kryesia është përgjegjëse për organizimin e fushatave zgjedhore, organizimin dhe zgjerimin e anëtarësis dhe grumbullimin e fondeve për aktivitete.

26.10 Kryesia propozon buxhetin vjetor të BNA_së të cilën e miraton Këshilli i Përgjithshëm.

Neni 27 (Mbledhjet dhe vendim-marrja e Kryesisë)

27.1 Mbledhjet e Kryesisë janë të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

27.2 Mbledhja organizohet atëherë kur prezent janë më shumë se gjysma e anëtarëve.

27.3 Mbledhjet udhëhiqen nga Kryetari dhe në mungesë të tij ato mundë të udhëhiqen edhe nga njëri prej nënkryetarëve ose nga Sekretari i Përgjithshëm.

27.4 Vendimet në Kryesi merren me shumicë votash, pra 50% + 1 votë.

27.5 Në rastë të voteve të barabarta vendos vota e Kryetarit.

Neni 28 (Nënkryetari dhe Sekretari)

28.1 Nënkryetari

28.1.1 Nënkryetari ushtron detyra të përcaktuara me rregullorën dhe përgjegjësit e Nënkryetarit.

28.1.2 Nënkryetari ushtron detyrat e Kryetarit në rast të mungesës së tij.

28.2 Sekretari

28.2.1 Sekretari i përgjithshëm është zyrtar i lartë administrativ në BNA.

28.2.2 Merret me organizimin dhe funksionimin e përditshëm të Partisë.

28.2.3 Nënshkruan dokumentet financiare të partisë me miratimin e kryetarit të BNA_së.

28.2.4 Administron përdorimin e vulave të parties.

28.2.5 Bashkërendit punët e degëve duke e njoftuar Kryetarin e Partisë.

Neni 29 (Përfaqësimi i partisë)

29.1 BNA_në e përfaqëson Kryetari i BNA_së

29.2 Në mungesë të Kryetarit, BNA_në e përfaqëson Nënkryetari, Sekretari i Parë, ose edhe njëri nga anëtarët e Kryesisë.

Neni 30 (Këshilli për ankesa)

30.1 Zgjidhet nga Kuvendi me votë të fshehtë ose të hapur.

30.2 Përbëhet nga 3 anëtarë:

30.2.1 Kryetari i Këshillit të Ankesave dhe

30.2.2 2 anëtare tjerë.

30.3 Shqyrton dhe mer vendim për çdo ankesë eventuale nga të gjitha forumet e BNA_së.

30.4 Anëtarët e këshillit kan mandate 4 vjeqare.

- 30.5 Anëtarët e këshillit nuk mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të strukturave tjera të parties.
- 30.6 Në këtë këshill nuk mund të ankimohen vendimet e Kuvendit.
- 30.7 Vendimet e këshillit janë të detyrueshme për zbatim nga organet e BNA_së.

Neni 31 (Financat)

- 31.1. Organizimi dhe kontrolli financiar
 - 31.1.1 Zyrtari financiar për mbarëvajtjen e financave të BNA_së
 - 31.1.2 Komisioni i mbikqyerjes së financave.
 - 31.1.4 Raportimi i rregullt tek kryesia e BNA_së dhe organet shtetërore kompetente.
 - 31.1.4 Informimi i anëtarëve rreth gjendjes financiare bëhet në bazë të kërkesave të tyre në kuvendin zgjedhor dhe në forumet e parties
 - 31.1.5 Transikcionet financiare kryen nga zyrtari financiar me aprovim të Kryetarit.
- 31.2 Financimi
 - 31.2.1 Mjetet e alokuara nga Buxheti i Shtetit për partitë.
 - 31.2.2 Mjetet nga anëtarësia dhe donacionet e ndryshme të bizneseve apo personave fizik/juridik, si dhe nga donacionet e huaja.
 - 31.2.3 BNA_jë ka xhirollogarinë e saj zyrtare.

Neni 32 (Shpërndarja, bashkimi apo shkrirja e parties)

BNA mund të shpërndahet, bashkohet apo shkrihet në këto raste:

- 32.1 Nëse vendosin 2|3 e anëtarëve të Kuvendit në mbledhjen e rregullt apo të jashtëzakonshme.
- 32.2 Me rastin e shpërbërjes, për pasurin e BNA_së vendos kuvendi, njëherit pasuria nuk mund të kaloj apo tjetërsohet tek individit.

Neni 33. Amendamenti i statutit në raste të ndryshimit të ligjit mbi partit

- 33.1 Amendamenti i statutit mund të bëhet me shumicë të voteve të delegateve të Kuvendit në rast se kemi ndryshim të ligjit mbi partit ose me 2|3 e votave të Këshillit të Përgjithshëm.